



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1796/Prot.

Tiranë, më 26.07.2021

VENDIM

Nr. 27 datë 22.07.2021

**“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË DISA NDRYSHIMEVE NË STRUKTURËN  
ORGANIZATIVE TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA, TË UNIVERSITETIT  
TË TIRANËS”**

Bazuar në nenin 38, pika 1, gërma ç), të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31, gërma dh), të Statutit të UT-së; në Vendimin nr.51, datë 23.06.2021, të Dekanatit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në mbledhjen e datës 22.07.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në strukturën organizative në 3(tre) njësitë bazë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në lidhje me numrin në plan të personelit akademik me kohë të plotë, konkretisht:

- Departamenti i gjuhës italiane: ishte 25 personel akademik, bëhet 24 personel akademik me kohë të plotë;
- Departamenti i gjuhëve sllavo-ballkanike: ishte 14 personel akademik, bëhet 12 personel akademik me kohë të plotë;
- Departamenti i gjuhës gjermane, ishte 17 personel akademik, bëhet 20 personel akademik me kohë të plotë.

2. Vendimi t’i përcillet Bordit të Administrimit të UT-së.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Artan Hoxha

